



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31155-00559-80-2021 Data e Regjistrimit : 25/01/2021
Numri i Vendimit: 80-2021-972 Data e Vendimit : 06/04/2021

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 06/04/2021mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites {...} Paditur DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE

Objekti:Konstatimin e pavlefshmerise relative dhe shfuqizimin e vendimit nr. 524/22 protokolli, date 12.10. 2020, te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale. Ndryshimin e tij duke vendosur vijimin e procedurave per shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me kerkesen e paditesit per apelimin e vendimit te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve nr.524/16 prot., date 31. 03.2020.

Detyrimin e te paditurit te paguaj te gjitha shpenzimet gjyqesore.

Baza Ligjore: Neni 4; neni 15; neni 41; neni 116; neni 117; i Kushtetues se Republikes se Shqiperise; Marreveshja e Stabilizim Asocimit; neni 41 i Kartes se te Drejtave Themelore te Bashkimit Evropian - EUCHFR; neni 12; neni i 17 te Kodit Evropian i Sjelljes se Mire Administrative - ECGAB; nenet 32 , 153 te K. Procedures Civile; Neni 2, pikat 1,2, 5, 6 ,7; neni 3 pikat 1,2,3; neni 7 germa (a); neni 10 pika 1; neni 11 pika 1; neni 15 germa (a); neni 16 pika 1; neni 17 pika 1, germa (a); neni 18 pika 1, germa (a); neni 35 pika 3; neni 37 pika 1; neni 40, germa (a); te Ligjit Nr. 49/2012, "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", i ndryshuar; Neni 1; neni 2 pika 1, germa (a) ; neni 3 pika 1, germa (a), pika 3, pika 6; pika 7, germa (a), pikat 8, 9, 10, 11,12; neni 4; neni 5; neni 6; neni 10, pikat 1,3; nenet 11 deri 18; neni 22; neni 30, germat (9),(e); neni 33; neni 41 pika 3, germa (b); neni 42; neni 43; neni 44; neni 45; neni 47; neni 48; nenet 54-55; neni 58; neni 59; neni 60; neni 62; neni 66; nenet 87-89; nenet 90-97; neni 107; neni 109, pika 1, germat (b), (d); etj., te Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise", (ne vijim shkurt "KPA"); neni 184/p dhe neni 193/b te ligjit Nr. 9947, date 7.7.2008, « Per Pronesine Industriale », i ndryshuar, (ne vijim shkurt "LPI"); nenet 1; 3; 4, Vendimi i Keshillit te Ministrave Nr. 752, date 29. 12. 2018" Per miratimin e Rregullores se organizimit, funksionimit dhe percaktimit te mases se shperblimit te anetareve te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale", (ne vijim shkurt "Rregullore BA"); nenet 42; 43; 44, Vendimi Nr. 315, date 31.5.2018 "Per miratimin e Rregullores per Markat"

Gjykata konstaton kryesisht se geshtja ben pjese ne juridiksionin e saj gjyqesor ne baze te nenit 36 e vijues te Kodit te Procedures Civile dhe se ne baze te neneve 7, shkronja "a" dhe 11, pika 1 te ligjit nr.49/2012 date 3.5.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", i ndryshuar^[1], ajo ka kompetencen lendore dhe tokesore per gjykimin e geshtjes.

Kjo per faktin se akti administrativ objekt kundershimi gjyqesor, eshte nxjerre nga nje organ publik me seli ne Tirane, veprimtaria e te cilit kontrollohet nga gjykata administrative e shkalles se pare Tirane.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te geshtjes te zhvilluar ne prani te paleve, te cilet ne perfunim te gjykimit te geshtjes kerkuan:

Pala paditese nepermjet administratorit: pranimin e padise sipas objektit te saj;

Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale nepermjet perfaqesuesit me autorizim: rrezimin e padise si te pabazuar ne ligj dhe prova;

Personi i trete Kantina e Pijeve {...} sh.a nepermjet perfaqesueses me autorizim: rrezimin e padise si te pabazuar ne ligj dhe prova;

ne mungese te avokatures se shtetit e cila relatoi mospjesemarrjen ne gjykim, Gjykata, pasi shqyrtoi provat e marra dhe u konsultua me ligjin lidhur me kete geshtje,

[1] Referuar ne vijim te vendimit si "Ligji 49/2012"

VEREN :

Veren:

Shoqeria {...} shpk i eshte drejtuar gjykates administrative te shkalles se pare Tirane ne date 25 Janar 2021, duke paditur Drejtorine e Pergjithshme te Pronesise Industriale (referuar me tej ne vendim me akronimin "DPPI"), duke thirrur ne cilesine e personit te trete Kantinen e Pijeve {...} sh.a, me kerkimin e sipercituar ne objektin e padise.

Gjykata procedoi me njoftimin e padise dhe akteve edhe ndaj Avokatures se Shtetit prane Ministrise se Financave dhe Ekonomise, sipas percaktimit qe jep neni 79/a i Kodit te Procedures Civile, e cila mori nuk pjese ne gjykim, por relatoi mospjesemarrjen me aktin e depozituar ne gjykate date 9.2.2021 nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

A. RRETHANAT E QESHTJES

Shoqeria paditese {...} shpk, ka paraqitur prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale kerkesen me numer AL/T/2017/524, per regjistrimin e markes {...} (*Marke fjale*), kerkesa e cila eshte depozituar ne DPPI duke marre si date depozitimi, ne kuptim te nenit 146, te ligjit nr.9947 "Per pronesine industriale", i ndryshuar, daten 1.6.2017.

Aplikanti ka kerkuar mbrojtjen e markes per mallrat e klases 33 te Klasifikimit te Nices, ne menyre specifike per mallrat:

Klasa 33: "Pije alkoolike (perveg birres); brandy (distilat i veres), brendi, pije alkoolike te distiluara; likere (te bera nga distilimi); pije dixhstive (likeret dhe pije te destiluara qe nxisin tretjen), aperitive, biter, cider, (musht i zier); kokteje; xhin (raki e manave te dellinjjes); likere; rum; vodka; uiski; vere; hidromel (pije alkoolike nga mjalti), perzierjet e pergatitura paraprakisht te pijeve alkoolike, te cilat nuk jane te bazuara ne birre, ekstrakte alkoolike

Kerkesa per regjistrimin e markes {...} (*marke fjale*), me numer AL/T/2017/524, eshte publikuar ne Buletinin e Pronesise Industriale ne date 8.5.2019, ne perputhje me parashikimet e nenit 151 te ligjit nr.9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale", i ndryshuar.

Kunder kesaj marke, eshte depozituar kerkesa per kundershhtimin e regjistrimit te saj nga subjekti Kantina e Pijeve {...} sh.a, me date 30.7.2019. Dhoma per Shqyrtimin e Kundershhtimeve prane pales se paditur, me vendimin e saj nr.524/16 prot., date 31.13.2020, ka vendosur: "*Pranimin e kundershhtimit te regjistrimit te markes {...}, me numer aplikimi AL-T-2017-524, me aplikant shoqerine "Adol, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar", dhe refuzimin e regjistrimit te saj*".

Ne daten 13.7.2020, shoqeria paditese ka depozituar prane DPPI kerkesen drejtuar Bordit te Apelit (BA), per apelimin e vendimit te dhomes per shqyrtimin e kundershhtimeve, numer 524/16 prot., date 31.13.2020.

Sekretari i Bordit te Apelit, pasi ka kontrolluar kerkesen per apelim, ka konstatuar se asaj i mungon dokumenti "Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit" dhe me relacionin nr.524/20 prot., date 15.8.2020, ka njoftuar Bordin e Apelit. Ky i fundit, me vendimin nr.524/22 prot., date 12.10.2020, ka vendosur si vijon:

•€€€€€€€€€€ Rrezimin e kerkeses per apelimin e vendimit nr. prot 524/16, date 31.3.2020 te DPPI per refuzimin e kerkeses per kundershhtimin e markes me nr. aplikimi AL-T-2017-524.

•€€€€€€€€€€ Kunder ketij vendimi, mund te behet ankim ne gjykate, brenda 45 diteve nga data e marrjes se njoftimit.

Shoqeria paditese, pas marrjes se njoftimit per vendimin e sipercituar me nr.524/22 prot., date 12.10.2020 te Bordit te Apelit prane DPPI, i eshte drejtuar gjykates administrative te shkalles se pare Tirane duke kundershhtuar vendimin ne fjale si te paligjshem dhe ne pasoje, detyrimin e pales se paditur te vijoje me procedurat per shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me kerkesen e paditesit per apelimin e vendimit te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershhtimeve nr.524/16 prot., date 31.3.2020.

Ne gjykim eshte thirrur ne cilesine e personit te trete edhe Kantina e Pijeve {...} i cili rezulton subjekt i interesuar, ne kushtet kur mbi ankesen e tij perpara organit kompetent administrativ (DPPI) nuk eshte gjendur i pranueshem aplikimi i pales paditese.

B. PRETENDIMET E PALEVE

Shoqeria paditese {...} shpk nepermjet administratorit te saj, kerkoi pranimin e padise, mbeshtetur ne keto argumente kryesore te parashtruara ne konkluzionet e fundit:

•€€€€€ Dokumentimi i paraqitjes se ankeses ne date 13 Korrik 2020 dhe fakti se relacioni i sekretarit te Bordit te Apelit, e'shte" mbajtur ne" daten 15 Gusht 2020, me numrin vijues 524/20 te" protokollit, tregojne" qarte" se ankesa e'shte" pranuar dhe e'shte" proceduar, pa konstatimin e ndonje" mungese te" formularit te" apelimit si dokumenti fillestar qe" identifikon ke'rkese'n, ke'rkuesin dhe procedure'n. Pala e paditur as pe'rpara dhe as gjate" ke'tij gjykimi, nuk ka paraqitur ndonje" prove" qe" te" ve'rtetoje" mungese'n e ndonje" prej 10 dokumenteve te listuara ne" faqet 16 dhe 17 te" ankese's se" padite'sit.

•€€€€€ Edhe ne'se e presupozojme" si te" vertete", mungesa fizike e formularit ne" momentin e ke'rkese's per apelim, nuk do duhet te" pe'rbe'nte shkak ligjor pe'r nde'rprerjen e procedure's dhe refuzimin automatik te" ankese's. Ankesa e padite'sit i plote'son te" gjitha kushtet pe'r t'u konsideruar ke'rkese', ne" kuptim te" nenit 41 te" Kodit te" Procedurave Administrative.

•€€€€€ Ke'rkesa duhet te" jete" "e pranueshme" ne" kuptim te" kriterave formale ligjore dhe organi publik ka detyrimin t'i verifikojte" ke"to ke'rkese ligjore dhe t'i jepet pale's munde'sia pe'r te" korrigjuar te" metat eventuale, para se te" vendoset pe'r vazhdimin e procedure's dhe marrjen e nje" vendimi te" shprehur sipas rastit. Ne" rastin kur konstatohen te" meta ne" kushtet e pranimit, (ge'rma "b", e pike's 2, te" nenit 44 te KPA), organi publik ka detyrimin te" nde'rmarre" veprime procedurale, nder te cilat njofton pale'n duke i kerkuar "plote'simin e te" metave"; pe'rcakton nje" afat te" arsyeshem procedural pe'r plote'simin e te" metave; i jep ndihme" aktive pale's pe'r plote'simin e te" metave.

•€€€€€ Sipas kuadrit ligjor specifik, ka disa hapa procedurale qe" duhet te" ndiqen dhe disa kushte kumulative qe" duhen pe'rmbushur pe'r apelimet e vendimeve te" Dhomes se" Kunde'rshhtimeve, te cilat jane" parashikuar me holle'si ne" Rregulloren e Bordit te" Apelit dhe ate" te" Markave. Sipas tyre: sekretari teknik i BA-se, (a)merr ne dorezim dosjen e kerkeses se depozituar per shqyrtim prane BA-se; (b) brenda nje muaji nga data e paraqitjes se kerkeses per apelim, kontrollon kerkesen nese permban dokumentet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te rregullores pe'r markat; (c) si personi i autorizuar konstaton fillimisht mangesite" dhe dergon njoftime per plotesimin e mangesive ose pasaktive te kerkeses; (g) njofton palet te depozitohen prane BA-se argumentet, prapesimet dhe gdo dokument tjeter te nevojshem te percaktuar ne ligj dhe rregulloren e markave, dhe rregulloren e tarifave. (d) brenda 10 (dhjete) ditesh nga plotesimi i te gjitha dokumenteve te percaktuara me ligj, nje kopje te dosjes se plote ia dergon secilit anetar te BA-se. (dh) ne rast se nje kerkesa per apelim nuk eshte paraqitur ne perputhje me kushtet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te Rregullores pe'r Markat, sekretari njofton me relacion me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kerkesen per apelim dhe njofton apeluesin per vendimin. (neni 3, pika 2, germa (b),(c); dhe neni 3, pika 3, Rregullore BA; neni 44, pika 1, 2 dhe pika 3 Rregullore pe'r Markat).

•€€€€€ Parashikimi i pike's 3 te" nenit 44 te" Rregullores per Markat, - sipas te" cilit, ne rast se nje kerkesa per apelim nuk eshte paraqitur ne perputhje me kushtet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te Rregullores, sekretari njofton me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kerkesen per apelim -, nuk e'shte" i programuar pe'r t'u aktivizuar ne" me'nyre" automatike. Ai e'shte" rezultatja e procedure's qe" duhet te" ndjeke" sekretari teknik i bordit, si ne'pune'si pe'rgjegje's, ne" plote'simin e t? gjitha detyrave te" tij qe" jane" parashikuar me detaje ne" Rregulloren e Bordit te" Apelit. (Neni 3). Vetem ne" rast se, pas njoftimit te" pe'rshhtatshe'm, pala nuk arrin te" plote'soje" te" metat e njoftuara dhe brenda afatit te" caktuar, ate'here" procedura "deklarohet e pe'rfunduar" ne" baze" te" nenit 90/3 KPA, e nenit 3, pika 2, germa (b),(c) e Rregullores se" Bordit, dhe sipas parashikimeve te pike's 3 te" nenit 44 te" Rregullores per Markat.

•€€€€€ Pala e paditur ka detyrimin per te respektuar nenin 10 te KPA qe lidhet me detyrimin e dhe'nies te" ndihme's aktive (pika 2, ge'rma "b"), parim qe konkretizohet si nga dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative, ashtu edhe ne dispozitat e ligjit te posagem. •€€€€€ Vetem mosplote'simi nga ana e pale's e "te" metave" brenda afatit te" caktuar, (pavare'sisht nga lloji dhe arsytet), do te" c^onte ne" deklarimin e pe'rfundimit te" procedure's pa nje" vendim pe'rfundimtar mbi thelbin e c^e'shtjes, ndaj pala e paditur ne vendimin e saj objekt gjykimi, ka bere interpretim dhe zbatim te gabuar te parashikimeve ligjore, ne" procedure'n administrative te" apelimit te" vendimit

te" Dhomes nr.524/16, duke passjelle" mospermbushjen e detyrimeve pe"r garantimin e interesave te" ligjshme kushtetuese te" shoqerise paditese.

Pala e paditur DPPI nepermjet perfaqesuesit te autorizuar, kerkoi rrezimin e padise, referuar argumenteve kryesore te meposhtme te pasqyruar ne materialin e depozituar me shkrim:

•€€€€ Shoqeria paditese ka depozituar prane DPPI ne date 13.7.2020 kerkesen drejtuar Bordit te Apelit (BA), per apelimin e vendimit te dhomes per shqyrtimin e kundershimeve, numer 524/16 prot., date 31.13.2020. Sekretari i Bordit te Apelit, ka kontrolluar kerkesen, bazuar ne piken 1 te nenit 44 te VKM 315, date 31.5.2018 (*citohet dispozita*) dhe ka konstatuar se kerkeses per apelim i mungon Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit. Ne keto kushte, Sekretari i Bordit te Apelit ka njoftuar nepermjet nje relacioni Bordin e Apelit, ne perputhje me piken 3, te nenit 44 te rregullores se markave qe parashikon se, ne rast se nje kerkese per apelim nuk eshte paraqitur ne perputhje me kushtet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te kesaj rregulloreje, sekretari i bordit te apelimt e njofton me relacion me shkrim bordin e apelit.

•€€€€ BA shqyrtoi nese kerkesa per apelim eshte paraqitur ne perputhje me parashikimet e pikes 3, te nenit 43, te VKM nr.315, date 31.5.2018 "Per Miratimin e Rregullores per Markat", dhe konstatoi se kerkeses per apelim i mungon Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit. Ne keto kushte, Bordi mbeshtetur ne piken 3 te nenit 44 te te VKM nr. 315, date 31.5.2018 "Per Miratimin e Rregullores per Markat", (*citohet dispozita*) ka vendosur rrezimin e kerkeses per apelimin e vendimit nr. prot 524/16, date 31.3.2020 te DPPI per refuzimin e kerkeses per kundershimin e markes me nr. aplikimi AL-T-2017-524.

•€€€€ Nga sa me sipër, Bordi i Apelit ka vepruar ne perputhje me parashikimet e neneve 43 dhe 44 te VKM nr.315, date 31.5.2018 "Per Miratimin e Rregullores per Markat" dhe se rrezimi i kerkeses per apelimin e vendimit te dhomes per shqyrtimin e kundershimeve eshte i drejte, per shkak se Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit se bashku me pagesen jane dokumente kyge per vijim e procedures, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Bordit te Apelit.

Personi i trete nepermjet perfaqesueses kerkoi rrezimin e padise, ne referim te ketyre argumenteve kryesore dhe perfundimtare: •€€€€ Mosmarveshja e krijuar ka lindur midis shoqerise paditese dhe DPPI dhe Kantina e Pijeve e thirrur ne cilesine e personit te trete nga {...} shpk, nuk mund te nderhyje ne nje vendimarrje te tille, pervegse mund te shprehe opinionet e saj.

•€€€€ Ne referim te te njejtave argumente dhe baze ligjore sikunder u cituan nga vete DPPI, personi i trete vlereson se Bordi i Apelit prane DPPI, ka vepruar ne perputhje me parashikimet e neneve 43 dhe 44 te VKM nr.315, date 31.5.2018 "Per miratimin e Rregullores per markat", dhe se rrezimi i kerkeses per apelimin e vendimit te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve eshte i drejte dhe i ligjshem. Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit, se bashku me pagesen, (sikurse percaktohet edhe ne rregulloren perkatese), konsiderohen si dokumente te domosdoshem per vijim e procedures, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Bordit te Apelit. •€€€€ Mungesa e nje prej ketyre si elemente te domosdoshem, pengon vijueshmerine e ndjekjes se procedures se ankimit. Nje rregullore e tille eshte e qarte edhe e aksesueshme nga te gjithë te interesuarit, prandaj pala paditese marre parasysh edhe faktin qe ka pasur edhe praktika te tjera te ngjashme me ankime, nuk duhej te kish neglizhuar nje dokument te tille me shume rendesi per vijueshmerine e procedures se ankimit te kerkuar prej vete paditesit.

C. LIGJI I ZBATUESHEM

l) Ligji nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise

Neni 41

Fillimi i procedures administrative

1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kerkese.

2. Fillimi i procedures kryesisht eshte ne diskrecionin e organit publik. Organi publik eshte i detyruar te filloje proceduren administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nenligjor parashikon fillimin e procedures;

b) situata faktike eshte e tille qe organi publik duhet te filloje proceduren administrative per mbrojtjen e interesit publik.

3. Procedura administrative konsiderohet e filluar:

a) me kryerjen e gdo veprimi procedural nga organi publik ne rastin e procedures se filluar kryesisht; ose

b) me paraqitjen e kerkeses perpara organit publik, ne rastin e procedures se filluar me kerkese.

Neni 44

Fillimi i procedures administrative me kerkese

1. Kur procedura administrative fillon me kerkese te pales, organi publik duhet te marre masat e nevojshme per pergatitjen sa me mire te geshtjes.

2. Organi publik shqyrton paraprakisht kerkesen lidhur me permbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe gdo kriter tjetër te parashikuar nga ligji dhe ne perfundim:

a) njofton palen kerkuese me shkrim se kerkesa eshte pranuar per vazhdimin e procedures;

b) njofton palen kerkuese me shkrim per plotesimin e te metave lidhur me plotesimin e kriterëve formale ligjore, duke caktuar nje afat te arsyeshem. Ne kete rast organi publik ndihmon ne menyre aktive palen per plotesimin e te metave te konstatuara. Mosplotesimi i te metave brenda afatit te caktuar perben shkak per mospranimin e kerkeses. Kunder ketij vendimi pala mund te ankohet sipas procedures te parashikuar ne kete Kod;

c) njofton palen kerkuese se jane te nevojshme veprime te metejshme administrative para se te vendose pranimin ose jo te kerkeses. Ne kete rast organi cakton edhe nje afat te arsyeshem per kryerjen e veprimeve te metejshme.

Neni 78

Bashkepunimi gjate hetimit administrativ

1. Pala bashkepunon me organin publik ne percaktimin e fakteve dhe rrethanave te nevojshme per zgjidhjen e geshtjes. Ligji mund te parashikojë shprehimisht detyrimin e metejshem te pales per te paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo per t'u paraqitur personalisht perpara organit publik.

(...)

Neni 90

Perfundimi i procedures administrative

(...)

3. Procedura administrative, e nisur me kerkese apo kryesisht, deklarohet e perfunduar pa nje vendim perfundimtar per geshtjen, ne rastet e parashikuara ne nenet 93-96 te ketij Kodi. Deklarata e perfundimit te procedures administrative, pa nje vendim perfundimtar per geshtjen, perben akt administrativ.

II) VKM Nr. 315, date 31.5.2018 "Per miratimin e Rregullores per markat"

Neni 43

Procedurat e apelimit

1. Procedura e apelimit kunder nje vendimi te zyres fillon me paraqitjen e kerkeses per apelim ne strukturen perkatese.
2. Kerkesa per apelim, sipas pikes 1, te nenit 42, te kesaj rregulloreje permban:
 - 2.1 *Formularin per apelimin vendimeve te refuzimit ne Dhomen per Shfuqizim/Zhvleresim qe i bashkelidhet kesaj rregulloreje, ne te cilin do te jepen te dhenat e meposhtme:*
 - 2.1.1 Emri dhe adresa e apeluesit, ne perputhje me nenin 62 te kesaj rregulloreje;
 - 2.1.2 Vendimi i zyres ndaj te cilit eshte depozituar apelimi;
 - 2.1.3 Numri i aplikimit te markes;
 - 2.1.4 Nje tregues qe percakton nese kemi te bejme me nje apelim te pjesshem apo te plote te vendimit te zyres.
 - 2.2 Bazen ligjore ku eshte mbeshtetur apelimi;
 - 2.3 Argumentet dhe/ose provat mbi te cilat mbeshtetet apelimi;
 - 2.4 Pagesen e tarifes perkatese;
 - 2.5 Autorizimin e perfaqesimit, nese apelimi eshte depozituar nga nje perfaqesues.
3. Kerkesa per apelim, sipas pikes 2, te nenit 42, te kesaj rregulloreje, permban:
 - 3.1 Formularin e aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit, qe i bashkelidhet kesaj rregulloreje, ne te cilin do te jepen te dhenat, si me poshte vijon:
 - 3.1.1 Emri dhe adresa e apeluesit, ne perputhje me nenin 62 te kesaj rregulloreje;
 - 3.1.2 Vendimi i zyres ndaj te cilit eshte depozituar apelimi;
 - 3.1.3 Numri i aplikimit ose i regjistrimit te markes;
 - 3.1.4 Nje tregues qe percakton nese kemi te bejme me nje apelim te pjesshem apo te plote te vendimit te zyres.
 - 3.2 Argumentet dhe/ose provat mbi te cilat mbeshtetet apelimi;
 - 3.3 Pagesen e tarifes perkatese;
 - 3.4 Autorizimin e perfaqesimit, nese apelimi eshte depozituar nga nje perfaqesues.
4. Kerkesa per apelim depozitohet si kerkese me vete ne dy kopje te njejta.
5. Qdo strukture perkatese, si: Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve, Dhoma per Shfuqizim/Zhvleresim dhe bordi i apelit, kur shqyrton nje kerkese, ne perputhje me kompetencat perkatese te parashikuara ne ligj dhe ne kete rregullore, duhet te shprehet me pranimin, pranimin e pjesshem ose rrezimin e kerkeses, objekt shqyrtimi.
6. Pretendimi i nje pale kundarshtare, qe nuk lidhet me objektin e kerkeses, nuk merret ne shqyrtim nga bordi i apelimit.

Neni 44

Shqyrtimi i kerkeseve nga bordi i apelimit

1. Sekretari i bordit te apelimit, brenda nje muaji nga data e paraqitjes se kerkeses per apelim, kontrollon kerkesen nese permban dokumentet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te kesaj rregulloreje.
2. Kur nje kerkese per apelim eshte paraqitur ne perputhje me piken 3, te nenit 43, te kesaj rregulloreje, sekretari i bordit te apelimit i dergon pales kunder se ciles eshte paraqitur apelimi, nje kopje te kerkeses per apelim, si dhe e njofton ate te paraqese, brenda dy muajve nga data e marrjes se njoftimit, argumentet dhe gdo dokument tjeter ne lidhje me apelimin.
3. Ne rast se nje kerkese per apelim nuk eshte paraqitur ne perputhje me kushtet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te kesaj rregulloreje, sekretari i bordit te apelimit e njofton me relacion me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kerkesen per apelim dhe njofton apeluesin per vendimin e marre.
4. Sekretari i bordit te apelimit, brenda 1 muaji nga mbarimi i afatit te parashikuar ne piken 2 te ketij neni, i paraqet bordit per shqyrtim kerkesen per apelim.
5. Bordi i apelit e shqyrton nje kerkese brenda tre muajve nga data e paraqitjes se saj ne bord.
6. Gjate shqyrtimit te nje kerkese apelimi, bordi i apelit, kur e konsideron te arsyeshme, ka te drejte t'u kerkoje paleve, nepermjet nje njoftimi me shkrim, te paraqesin prova dhe dokumente te tjera shtese brenda nje periudhe te arsyeshme, por, ne gdo rast, jo me vone se nje muaj nga data e marrjes se njoftimit nga pala.
7. Nese bordi i apelit e konsideron te arsyeshme, i fton palet ne seanca degjimore, si dhe u kerkon atyre te gjejne nje zgjidhje me mirekuptim, e cila, nese arrihet, duhet te materializohet ne nje marreveshje me shkrim te nenshkruar nga te dyja palet para noterit ose para bordit te apelit.
8. Sekretari i bordit i njofton palet e interesuara menjehere pas marrjes se vendimit te bordit te apelit, por, ne gdo rast, jo me vone se 1 muaj nga marrja e vendimit.

Neni 45

Efekti i vendimeve

1. Vendimi i bordit te apelit merr forme te prere nga e nesermja e dates se mbarimit te afatit per ankim ne gjykate, kur asnje nga palet nuk ka bere ankim kunder vendimit te bordit.
2. Kur vendimi i bordit te apelit ose vendimi i gjykates merr forme te prere, zyra ekzekuton vendimin sipas legjislacionit ne fuqi.
3. Ne rast ankimi te vendimit te bordit te apelit ne gjykate, ankimesi ka detyrimin te njoftoje DPPI-ne brenda 1 muaji nga data e depozitimit te ankimit ne gjykate, me qellim qe te shmanget ekzekutimi i vendimit te bordit te apelit.

D. ARSYETIMI LIGJOR

Nga sa pretendohet ne padi dhe provohet nga aktet shkresore te paraqitura ne gjykim nga palet, gjykata analizon si me poshte:

Se pari: geshtja gjendet e trajtueshme nga kjo gjykate, ne kushtet kur mosmarreveshja ka lindur per shkak te aktit administrativ te organit publik, sipas nenit 7, shkronja "a" te Ligjit 49/2012, i cili thote se gjykata administrative, nder te tjera eshte kompetente edhe per mosmarreveshjet qe lindin nga aktet administrative individuale te nxjerra gjate ushtrimit te veprimtarise administrative nga organi publik. Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale eshte organ publik ne kuptim te ligjit nr.49/2012, neni 2, pika 6, dhe ka disponuar ne kuader te veprimtarise se zhvilluar prej saj me akt administrativ me pasoja per palen paditese.

Se dyti: pala paditese justifikohet ne paraqitjen e padise, sipas nenit 15, shkronja "a" te ligjit 49/2012, ne kushtet kur akti administrativ per refuzimin e shqyrtimit te ankimit te subjektit, cenon interesin e shoqerise per akses administrativ dhe gjyqesor ne shqyrtimin e te drejtes se tij te pretenduar sipas ligjit material. Sipas dispozites se sipercituar: *"Te drejten e ngritjes se padise e ka: a) gdo subjekt, qe pretendon se i eshte cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit publik"*.

Se treti: Gjykata konstaton se kjo geshtje eshte gjykuar ne themel te pretendimeve te saj, pasi nuk u gjend e shkelur asnje dispozite ligjore lidhur me mosrespektimin e kushteve formale te padise me pasoje mospranimin e saj ne gjykate (nenet 16 deri 18 te Ligjit 49/2012).

Konkretisht, lidhur me kushtet e pranueshmerise:

a) **Shterrimi i ankimit administrativ nuk eshte i detyrueshem** (neni 16, pika 2/a e Ligjit 49/2012). Nisur nga fakti se, vendimi ne fjale eshte nxjerre pikerisht nga struktura qe shqyrton ankimet ne rruge administrative (Bordi i Apelit prane DPPI), ankimi ndaj ketij te fundit

mund te paraqitet vetem ne gjykate, sikunder i eshte njohur e drejta e ankimit subjektit aplikant dhe te refuzuar ne vete disponimin e vendimit te DPPI-se, objekt i ketij gjykimi.

b) **Nga pikepamja e objektit te padise te lejuar ne gjykim administrativ:** pala paditese ka kerkuar shfuqizimin e aktit administrativ, si nje nder objektet e parashikuara nga neni 17 i Ligjit 49/2012, pika 1, shkronja "a" e te cilit, parashikon se padia ngrihet nder te tjera edhe *per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrativ*, si dhe eshte kerkuar detyrimi i pales se paditur per te kryer nje veprim te caktuar i cili eshte refuzuar sipas nenit 17 te Ligjit 49/2012, pika 1, shkronja "g" e tij.

c) **Eshte respektuar afati ligjor per ngritjen e padise administrative.** Konkretisht, vendimi administrativ i nxjerre nga DPPI daton 12.10.2020, ndersa padia eshte depozituar ne gjykatën administrative te shkalles se pare Tirane me date 25.1.2021, por se praktika e plote perfshire dhe vendimin ne fjale, i eshte komunikuar paditesit me shkresen nr.5245/4 prot., date 28.12.2020 te DPPI-se. Ne pasoje, paraqitja e padise ne date 25 Janar 2021, vleresohet nga gjykata ne respektim te afatit te ankimit ne rruge gjyqesore ndaj vendimit te DPPI-se, Lcili eshte brenda afatit specifik 45 ditor sipas ligjit te pergjithshem mbi gjykimin administrativ (*neni 18, pika 1, shkronja "a" e Ligjit 49/2012-1**), sikunder pasqyrohet afati edhe ne vete permbajtjen e vendimit te kundershuar te DPPI-se.

Se katerti: Lidhur me thelbin e mosmarreveshjes administrative qe prezantohet perpara saj, gjykata konstaton se vendimi objekt i ketij gjykimi, me nr.524/22 prot. date 12.10.2020 i Bordit te Apelit prane DPPI, ne thelb te tij nuk ka trajtuar ankimin administrativ te subjektit, por ka disponuar per refuzimin e kerkeses per apelim per mungese te nje prej dokumenteve te kerkuara dhe konkretisht per Formularin e aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit.

Sikunder u parashtrua ne gjykim nga pala paditese dhe rezultoi nga dokumentet e sjella ne cilesine e proves, shkesa e shoqerise per depozitim e dokumenteve e'shte" pranuar nga pala e paditur ne daten 13 Korrik 2020; ka marre" nr.524/19 prot., date" 13.7.2020 dhe e'shte" regjistruar e protokolluar ne'pe'rmjet sistemit informatik, ku ka marre" *she'nimin:"TM.Apelim i Vendimit ne" Bordin e Apelit; dhoma pe r shqyrtimin e kundershimeve AL/20/006691, received on 13/07/2020, 12.29.41 by L.... Affects file AL/T/2017/524 DORUNTINA.* " Gjukata e gjen ne korrektesi te ligjit pretendimin e paditesit se ankesa e tij i plote'son kushtet pe'r t'u konsideruar ke'rkese" ne" kuptim te" nenit 41 te" Kodit te" Procedurave Administrative, pasi ankesa ne fjale:

- i. E'shte" shprehja e nje" ke'rkese te" caktuar nga nje" person juridik (ke'rkese e paditesit per te" ankimuar vendimin e Dhome's);
- ii. E'shte" depozituar ne" nje" organ publik (DPPI);
- iii. Ne" pe'rmbajtje, e'shte" nje" ke'rkim qe" organi te" nde'rmarre" nje" veprim administrativ i cili nuk e'shte" ende objekt i nje" procedure administrative ne" vazhdim (procedure'n e apelimit te" vendimit te" nje" organi administrativ me" te" ule't);
- iv. pe'r te" cile'n ke'rkuesi pretendon se ka interes te" ligjshe'm (be'het fjale" pe'r refuzimin e nje" ke'rkese te" padite sit pe'r regjistrim marke tregtare).

Pala e paditur dhe person i trete prapesuan me argumentin se, Bordi i Apelimit ka disponuar me refuzim te ankimit per shkak se mungonte nje nder dokumentet me te rendesishem qe duhet te shoqerojne ankimin administrativ, sikunder e parashikon VKM Nr.315, date 31.5.2018 "Per miratimin e Rregullores per markat", e cila ne piken 3 te nenit 43 te saj, percakton listen e dokumenteve qe shoqerojne kerkesen per apelim ku i renditur i pari rezulton Formulari i aplikimit per apelimin e vendimit ne bordin e apelit, me te dhenat e nevojshme, keto te fundit gjithashtu te percaktuara nga Rregullorja ne kete pike.

Paditesi parashtrroi gjyqesisht disa hapa procedurale qe" duhet te" ndiqen dhe kushtet kumulative qe" duhen pe'rmbushur pe'r apelimet e vendimeve te" Dhome's se" Kunde'rshtimeve, te cilat jane parashikuara me holle'si ne" Rregulloren e Bordit te" Apelit dhe ate" te" Markave, si vijon: sekretari teknik i BA-se: (a) merr ne dorezim dosjen e kerkeses se depozituar per shqyrtim prane BA-se; (b) brenda nje muaji nga data e paraqitjes se kerkeses per apelim, kontrollon kerkesen nese permban dokumentet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te rregullores pe'r markat; (c) si personi i autorizuar konstaton fillimisht mangesite" dhe dergon njoftime per plotesimin e mangesive ose pasaktive te kerkeses; (g) njofton palet te depozitohen prane BA-se argumentet, prapesimet dhe gdo dokument tjeter te nevojshem te percaktuar ne ligj dhe rregulloren e markave, dhe rregulloren e tarifave. (d) brenda 10 (dhjete) ditesh nga plotesimi i te gjitha dokumenteve te percaktuara me ligj, nje kopje te dosjes se plote ia dergon secilit anetar te BA-se, (dh) ne rast se nje kerkese per apelim nuk eshte paraqitur ne perputhje me kushtet e parashikuara ne piken 3, te nenit 43, te Rregullores pe'r Markat, sekretari, njofton me relacion me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kerkesen per apelim dhe njofton apeluesin per vendimin.

Gjukata veren se, pala e paditur ka gabuar kur, pas konstatimit se mungon akti ne fjale ka proceduar me vendim per refuzimin e ankimit, pa i dhene mundesine subjektit qe te njoftohet per kete konstatim dhe ta plotesoje ate. Ne nje procedure administrative, asnje pengese nuk ka organi me i larte administrativ me kompetence shqyrtimi te ankimeve per t'iu drejtuar nenit 44, pika 2/b te KPA-se, sipas te cilit organi publik ndihmon ne menyre aktive palen per plotesimin e te metave te konstatuara dhe vetem mosplotesimi i te metave brenda afatit te caktuar, perben shkak per mospranimin e kerkeses.

Per me teper, pala paditese e ka cituar formularin si dokument - pjese e akteve te depozituara se bashku me ankimin prane pales se paditur, dhe vetem ky verifikim, duhej te kish mjaftuar per te kerkuar Bordi i Apelit prane DPPI plotesimin e dokumentacionit.

Gjukata veren se qellimi i pikes 3 te nenit 44 te Rregullores per Markat, nuk eshte mungesa e nje dokumenti fizikisht pa i dhene mundesine subjektit, qe edhe nese nuk disponohet ne dosje te mund te riparaqitet. Per kete, VKM nr.752 date 19.12.2028 "Per miratimin e Rregullores se organizimit, funksionimit dhe percaktimit te mases se shperblimit te anetareve te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale", ka parashikuara nder detyrat e Sekretarit teknik te Bordit te Apelit edhe konstatimin e mangesive dhe dergimin e njoftimeve per plotesimin e mangesive ose pasaktive te kerkeses tek subjekti qe mban barren e plotesimit te tyre. Ky konstatim nuk eshte shoqeruar me dhenien mundesi te subjektit dhe vendimi ne fjale i pales se paditur nuk gjendet ne perputhje me frymen e ligjit. Nga sa me siper, gjykata arrin ne perfundimin se, padia e shoqerise paditese qendron dhe duhet te pranohet, duke vendosur gjykata shfuqizimin e vendimit nr.524/22 prot., date 12.10.2020 te Bordit te Apelit prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale si dhe detyrimin e Bordit te Apelit prane pales se paditur te procedoje me marrjen ne shqyrtim te ankimit te shoqerise paditese. Ne kuptim te efekteve te ketij vendimi, pala e paditur duhet t'i jape mundesi pales paditese te plotesoje dokumentacionin dhe ne vijim te vleresoje mbi thelbin e ankimit te paraqitur.

Lidhur me ekzekutimin e ketij vendimi, sipas nenit 41/b te ligjit Nr.49/2012, gjykata veren se, ekzekutimi i vendimit ne fjale i takon pales se paditur, dhe konsiston ne kryerjen e veprimeve te siperctuara (marrjen ne shqyrtim te ankimit te shoqerise paditese, pas dhenies mundesi te plotesoje dokumentacionin dhe ne vijim te vleresoje mbi thelbin e ankimit te paraqitur), menjehere me marrjen e vendimit forme te prere dhe komunikimin e tij nga gjykata, (ne situaten e ushtrimit te ankimit, do te ishte e tille gjykata administrative e apelit Tirane), ndersa ekzekutimi i detyrueshem do te behet nga permbartuesi gjyqesor.

Lidhur me shpenzimet gjyqesore, te evidentuara gjate gjykimit, ato jane ne ngarkim te pales paditese sipas nenit 106 te Kodit te Procedures Civile dhe perbehen nga tarifa per ngritjen e padise ne masen 3.000 leke provuar me pullat e ngjitura ne fleten e pare te padise + njoftime 300 leke, sipas mandatit te dates 25.1.2021 te leshuar nga gjykata administrative e shkalles se pare Tirane.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

PER KETO ARSYE

Gjykata, mbeshtetur ne nenet 306 dhe 310 te Kodit te Procedures Civile dhe nenit 40, pika 1/a te ligjit nr.49/2012, date 3.5.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar,

[1] Ligji 49/2012, neni 18, pika 1: "Padia kunder veprimet administrativparaqitet ne gjykate brenda 45 diteve. Ky afat fillon nga: a) data e njoftimit, sipas menyres se percaktuar ne ligj, te aktit administrativ te organit epror, qe ka shqyrtuar ankimin administrativ.."

VENDOSI:

1. Pranimin e padise se shoqerise paditese {...} shpk.
2. Shfuqizimin e vendimit nr.524/22 prot., date 12.10.2020 te Bordit te Apelit prane Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, si dhe detyrimin e Bordit te Apelit prane pales se paditur te procedoje me marrjen ne shqyrtim te ankimit te shoqerise paditese.
3. Ekzekutimi i ketij vendimi do te kryhet nga pala e paditur menjehere me marrjen e vendimit forme te prere dhe komunikimin etij, ndersa ekzekutimi i detyrueshem do te behet nga permbaruesi gjyqesor.
4. Shpenzimet gjyqesore dhe ato ne fazen e ekzekutimit te vendimit jane ne ngarkim te pales se paditur.
5. Kunder ketij vendimi, mund te behet ankim ne gjykaten administrative te apelit Tirane, brenda 15 diteve nga e nesermja enjoftimit te vendimit te arsyetuar.

- U shpall ne Tirane, sot me date 6 Prill 2021

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}